



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Qytetërim i Gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore: 20 leksione, 20 seminare

Semestri kur zhvillohet: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo lëndë mëton të japë një panoramë të përgjithshme të qytetërimit francez, duke u mbështetur në një numër piketash : njohuri gjeografike, historike, politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të jetës së përditshme

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të pajisë studentët me njohuri të përgjithshme dhe informacione mbi kulturën, qytetërimin francez dhe Francën e ditëve tona.

Objektivat specifike lëndore:

Lënda synon që studenti :

- të marrë njohuri dhe t'i thellojë ato mbi vendin gjuhën e të cilit po studion
- të relativizojë qëndrimet dhe sjelljet e tij nga një perspektivë ndërkulturore
- të dijë të orientohet dhe të sillet në një realitet dhe shoqëri të ndryshme nga ajo ku jeton
- të jetë në gjendje të shfrytëzojë literaturë në frëngjisht duke e përdorur në mënyrë të përshtatshme